



KUVENDI I SHQIPËRISË SHQYRTON PROJEKTREZOLUTËN KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT

SHQIPËRIA VOTON SOT REZOLUTËN KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT

FAQE 4-5

OPINION

PROPOZIM-REZOLUTA E SHQIPËRISË E LË SPECIALEN TË ZHVESHUR F. 6

Shkruan:
Agron HOTI



KUJT NUK DUHET T'I BESOHEM ASPAK, LAJÇAKUT APO BISLIMIT? F. 6

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë sot (e enjte) do ta shqyrtojnë projektrezolutën e propozuar nga Partia Socialiste kundër raportit të Dick Martyt, i cili i kishte paraprirë formimit të Gjykatës Speciale. Kryetari i deputetëve të PS-së, Taulant Balla, i ka ftuar të gjithë

deputetët shqiptarë që ta votojnë këtë projektrezolutë. Ai ka thënë se qëllimi i kësaj projektrezolute është mbrojtja e së vërtetës dhe UÇK-së. "Duhet të jetë një moment solemn heqja e një balte të pamerituar të hedhur padrejtësisht kundër luftës çlirimtare të Kosovës", ka thënë Balla

AKTUALE



KDI: SHSKUK-ja DËMTON BUXHETIN PËR RRETH 57 000 EURO DUKE BLERË OKSIGJENIN MË SHTRËNJTË F. 7

ABDIXHIKU E KAMBERI BISEDONJË PËR GJENDJEN E SHQIPTARËVE NË LUGINË F. 5

EKONOMI



KUSH MUND TË PUNËSOHET ME SKEMËN E RE? F. 8

HOTI KRITIKON QEVERINË KURTI: INFLACIONI NUK MUND TË LUFTOHET ME LIGJE F. 8



KOSOVA ME PROJEKTLIGJ PËR SANKSIONE NDAJ SHKELËSVE TË HUAJ TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

FAQE 5



DY VIKTIMA DHE AFËR 1 800 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mbr: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Siria shkëput raportet me Ukrainën

DAMASK, 20 KORRIK - Siria ka njoftuar të mërkurën se ka shkëputur raportet me Ukrainën në mbështetje të aleates së saj të ngushtë, Rosisë. Siria tha se ky vendim është marrë në përgjigje të një

lëvizjeje të ngjashme të Kievit. “Republika Arabe e Sirisë ka vendosur t’i shkëpusë raportet diplomatike me Ukrainën në përputhje me parimin e reciprocitetit dhe në përgjigje të vendit të qeverisë ukrainase”, tha për

agjencinë shtetërore të lajmeve, SANA, një zyrtar i Ministrisë së Jashtme, i cili nuk u identifikua. Muajin e kaluar Ukraina njoftoi se ka shkëputur raportet diplomatike me Sirinë, pasi kjo e fundit njohti

pavarësinë e rajoneve lindore ukrainase, Donjeck dhe Luhansk. Kievi ngjashëm ka vepruar në korrik edhe me Korenë e Veriut, e cila, po ashtu, njohti pavarësinë e dy republikave separatiste, që mbështeten nga Rusia.



Franca duhet “të investojë më shumë në luftimin e zjarreve”

PARIS, 20 KORRIK - Franca duhet të investojë më shumë para për t’i luftuar zjarret e egra, tha të mërkurën ministri i Agrikulturës, Marc Fesneau, teksa presidenti Emmanuel Macron pritet ta vizitojë rajonin Zhironde, që është goditur më së keqi nga zjarret. “Ne duhet të shkojmë më tutje”, tha Fesneau për Televizionin France 2. Fesneau tha se qeveria veçse ka ndarë 850 milionë euro për ta përmirësuar flotën e avionëve për shuarjen e zjarreve dhe një miliard euro për rimbjelljen e pemëve. “Ne duhet të përballemi me një situatë mjaft të jashtëzakonshme. Po flasim për më shumë se 20 000 hektarë të prekura nga zjarret në

Zhironde, 1 500 në Finistere dhe 1 500 në Bush du Ron”, shtoi Fesneau, duke iu referuar dëmeve të shkaktuara nga zjarret e fundit në jug të Francës. Që nga 12 korriku zjarrfikësit në jugperëndim të Francës po përballen me zjarre të egra. Vala e të nxehtit ka kapluar Evropën, teksa në Britani të martën u shënuan për herë të parë temperatura mbi 40 gradë celsius. Gjermania të martën, po ashtu, regjistroi ditën më të nxehtë të vitit, përkatësisht temperaturat arritën 39.5 gradë celsius. Valët e të nxehtit janë bërë më të zakonshme, më intensive dhe po zgjasin më shumë për shkak



të ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga njeriu. Organizata Botërore e Meteorologjisë

paralajmëruar se më e keqja ende nuk ka ardhur. “Në të ardhmen, këto valë të të nxehtit do të jenë normale dhe ne do të

shohim temperatura më ekstreme”, tha shefi i Organizatës Botërore të Meteorologjisë, Peterri Taalas.

Bideni nënshkruan urdhër kundër ndalimit të shtetasve amerikanë jashtë vendit



UASHINGTON, 20 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka nënshkruar një urdhër, që ka për synim t’i pengojë shtetet që të ndalojnë dhe ndëshkojnë padrejtësisht shtetasit amerikan jashtë vendit. Kjo masë do t’i lejojë agjencitë e qeverisë amerikane që të vendosin sanksione dhe masa të tjera ndaj atyre që “padrejtësisht ndalojnë” amerikanë, tha një zyrtar amerikan në një konferencë me gazetarë para se Bideni ta nënshkruante urdhrin. Kjo lëvizje vjen pasi, së fundmi, disa shtetas amerikanë janë arrestuar në Rusi, përfshirë edhe

basketbollisten Brittney Griner. Autoritetet ruse kanë thënë se kanë gjetur vaj kanabisi në valixhen e saj, kur ajo po kalonte nëpër aeroportin Sheremetevo në muajin shkurt. Shtetasi tjetër amerikan, ish-marinsi Paul Whelan, është arrestuar në dhjetor të vitit 2018 dhe është akuzuar për spiunazh. Ai ka mohuar akuzat, por në qershor të vitit 2020 është dënuar me 16 vjet burgim. Bideni “është i përkushtuar që të zgjidhen të gjitha këto raste”, tha zyrtari amerikan. Në të njëjtën kohë, Uashingtoni dëshiron të krijojë një strategji parandaluese që rrit pasojat për

marrjen e pengjeve, përfshirë vendosjen e sanksioneve financiare dhe të udhëtimit. Fondacioni James W. Foley thotë se 64 amerikanë aktualisht janë të ndaluar padrejtësisht ose po mbahen pengje. Ky fondacion është themeluar në emër të James Foley, gazetarit amerikan që u rrëmbye dhe vra në Siri më 2014. Urdhri i presidenti Biden vjen pasi ish-marinsi amerikan Trevor Reed u përfshi në një shkëmbim të të burgosurve, përkatësisht me Konstantin Yaroshenko, një pilot rus që kishte qenë i burgosur në ShBA nën akuzat për trafikim droge.

Tre kryediplomatë evropianë vizitojnë Kievin

KIEV, 20 KORRIK - Ministrat e Jashtëm të Republikës Çeke, Austrisë dhe Sllovakisë, kanë realizuar një vizitë të paparalajmëruar në Kiev, për ta shprehur mbështetjen e tyre për Ukrainën, shtet që tash e pesë muaj po përballlet me pushtimin rus. Ministri i Jashtëm çek, Jan Liptavsky, publikoi një video të shkurtër të arritjes së tij në kryeqytetin ukrainas më 20 korrik, dhe tha se ai do të takohet

me liderët ukrainas gjatë ditës. “Tronditëse të shohësh se çfarë i ka bërë lufta brutale e agresionit të Rosisë këtij shteti të bukur dhe popullit të tij. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë me Ukrainën”, shtoi ministri i Jashtëm austriak Alexander Schallenberg përmes një postimi të ndarë në “Twitter”. Televizioni austriak PULS 24 raportoi se edhe ministri i Jashtëm sllovak, Ivan Korcook, i është bashkuar kësaj vizite të

përbashkët në Kiev. Tre ministrat evropianë nuk kanë publikuar detaje të itinerarit të vizitës, edhe pse shumë diplomatë dhe liderë nga e mbarë bota kanë vizituar Ukrainën, pasi Rusia nisi pushtimin në fund të shkurtit. Vizitat e diplomatëve dhe liderëve kanë pasur për qëllim ta shprehin mbështetjen për Ukrainën, por edhe për ta parë nga afër dëmin e shkakuar nga lufta.



Kosova me projektligj për sanksione ndaj shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për sanksionet e shenjëstruara kundër shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut i cili përcakton kriteret dhe procedurën për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shenjëstruara kundër shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut, kryesve të huaj të veprave të rënda të korrupsionit dhe ka për qëllim mbështetjen e demokracisë, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 KORRIK - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e rregullt, të 89-n me radhë, ka miratuar vendime, politika dhe dokumente të fushës së përgjegjësisë të saj kushtetuese dhe ligjore. Është aprovuar Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe plani i veprimit 2022-2024 që paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, e cila do t'i garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve.

Në bazë të Kornizës së BE-së për Integrimin e Romëve, janë definuar pesë fusha të veprimit të cilat adresohen në Strategji: arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi. Këto fusha paraqesin prioritetet me të cilat duhet të ballafaqohet zbatimi i Strategjisë dhe ato ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Për secilën nga pesë fushat e Strategjisë është definuar një objektivi strategjik. Secili objektivi strategjik është

zbrëthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje në Planin e Veprimit janë zbrëthyer në rezultate dhe në aktivitete.

Është miratuar vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Qeveria ka miratuar edhe katër projektligje.

Projektligji për sanksionet e shenjëstruara kundër shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut i cili përcakton kriteret dhe procedurën për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shenjëstruara kundër shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut, kryesve të huaj të veprave të rënda të korrupsionit dhe ka për qëllim mbështetjen e demokracisë, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes i cili harmonizon strukturën e Ministrisë së Mbrojtjes me Ligjin për organizimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës i cili ka për



qëllim harmonizimin me ligjet bazike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës që do ta rregullojë fushën e disiplinës në Forcën e Sigurisë së Kosovës, obligimet dhe detyrimet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Miratimin nga qeveria e ka marrë edhe Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Rregullorja plotëson shtojcën e pestë të Rregullores të fushëveprimtarisë së Punëve të Brendshme të cilës i shtohen përgjegjësitë e sigurimit,

mbrojtjes dhe akomodimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, duke ofruar shërbime profesionale dhe mbështetëse përmes mekanizmave shtetërorë nga kjo ministri.

Është miratuar vendimi për aprovimin e Programit për Diplomaci Qytetare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i cili do ta sigurojë përfshirjen aktive të mërgatës dhe diasporës në politikëbërje dhe synon ta forcojë lidhjen e diasporës me Republikën e Kosovës, duke iu krijuar mundësi përfshirjeje të drejtpërdrejtë në institucionet e politikëbërjes dhe vendimmarrjes në vendin e origjinës, me qëllim të transmetimit të njohurive dhe përvojave. Për zbatimin e këtij programi qeveria ka ndarë mjetet

buxhetore në vlerë prej nëntëdhjetë mijë eurosh.

Në këtë mbledhje qeveria ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore për Masën 4.1 në zbatim të vendimit të qeverisë të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Sipas vendimit, do të vazhdojë pagesa shtesë prej 10 % e pagës bazë, por jo më pak se 60 euro për punonjësit e shërbimit shëndetësor të sektorit publik në periudhën korrik-dhjetor 2022.

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është miratuar vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 255 mijë eurosh për mbështetje të sigurimit të librave për nxënësit në komunat Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc.

Dy viktimat dhe afër 1 793 raste të reja me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 20 KORRIK (ER) - Dy persona kanë vdekur dhe 1 793 të tjerë kanë dalë pozitivë me koronavirus në 24 orët e fundit, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë e Kosovës. Sipas raportit ditor, rastet pozitive dolën pas testimit të 4 513 mostrave apo 39.72 për qind e mostrave dolën pozitive për sëmundjen Covid-19. Numri i rasteve të reja paraqet një rritje krahasuar me një ditë më parë, kur u regjistruan 842 infektive me koronavirus.

Në 24 orët paraprake janë shëruar 174 qytetarë, ndërkaq raste aktive me koronavirus aktualisht janë 8 035.

Sa i përket vaksinimit, autoritetet shëndetësore kanë administruar

263 doza të vaksinës kundër koronavirusit.

Në total, deri më tani në Kosovë 903 764 persona janë të imunizuar me një dozë të vaksinës. Me dy doza janë imunizuar 824 036, ndërkaq me tri doza 104 132 qytetarë.

Së fundmi, Kosova ka nisur ta japë edhe dozën e katërt të vaksinës për personat mbi 60 vjeç dhe, sipas të dhënave, deri më tani me dozën e katërt janë imunizuar 852 qytetarë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se Kosova po vazhdon të shënojë shtim të rasteve të reja të Covid-19 me tendencë të rritjes ditët në vijim.

"Fatkeqësisht sot janë raportuar dy raste të vdekjes nga kjo sëmundje!

Në vende të ndryshme të botës po regjistrohen raste të shumta me Covid-19, sepse pandemia Covid-19 nuk ka mbaruar. Me qëllim të përforsimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen të vaksinohen, me dozën e parë, të dytë dhe të tretë mund të vaksinohen të gjithë personat e moshës mbi 12 vjeç; me dozën e katërt mund të vaksinohen personat e moshës mbi 60 vjeç, me kusht që të kenë kaluar katër muaj nga marrja e dozës së tretë", ka njoftuar IKShPK-ja.



KUVENDI I SHQIPËRISË SHQYRTON PROJEKTREZOLUTËN KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT

Shqipëria voton sot rezolutën kundër raportit të Dick Martyt

Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë sot (e enjte) do ta shqyrtojnë projektrezolutën e propozuar nga Partia Socialiste kundër raportit të Dick Martyt, i cili i kishte paraprirë formimit të Gjykatës Speciale. Kryetari i deputetëve të PS-së, Taulant Balla, ka ftuar të gjithë deputetët shqiptarë që ta votojnë këtë projektrezolutë. Ai ka thënë se qëllimi i kësaj projektrezolute është mbrojtja e së vërtetës dhe UÇK-së. “Duhet të jetë një moment solemn rëndësia e heqjes së një balte të pamerituar të hedhur padrejtësisht kundër luftës çlirimtare të Kosovës”, ka thënë Balla

duhet të jetë në Kuvend sepse do të ishte nder dhe nuk kemi nevojë për sherrmajë. Rëndësia që ka, heqja e një balte të hedhur padrejtësisht kundër luftës së Kosovës, është në nderin e Kuvendit të Shqipërisë. Rezolutat e tjera më duken pa sens, ku 23 vjet nga çlirimi ne t'i kthehemi edhe një herë. Në seancë do t'ju njoh me të gjitha rezolutat. Janë 19 rezoluta dhe deklarata”, ka thënë Balla. Balla ka thënë se Partia Socialiste e ka iniciuar projektrezolutën mbi bazën e parimit se gjithçka duhet të hetohet. “Ne propozuesit iniciojmë këtë rezolutë mbi bazën e parimit se gjithçka duhet të hetohet. Kemi të bëjmë me një rast kur janë kryer verifikimet përkatëse dhe jemi në kushtet që t'i institucionalizojmë faktet dhe pas këtij momenti të iniciohet një raport dhe një rezolutë e re, rishikimi i atyre pretendimeve që sot nuk ekzistojnë më. Është në nderin e çdo anëtarit që të jetë në sallën e Kuvendit. Duhet të jetë një moment solemn heqja e një balte të pamerituar të hedhur padrejtësisht kundër luftës çlirimtare të Kosovës. Gjatë seancës do të njiheni me të gjitha qëndrimet tona për luftën në Kosovë”, ka thënë Balla, duke

shtuar se objektivi i kësaj rezolute është mbrojtja e UÇK-së dhe drejtuesve të saj. “Mendoj se dokumenti i rezolutës është një dokument parimesh, mbërritja në këtë dokument ka kërkuar muaj me radhë pune dhe mendoj se dokumenti e ka brenda edhe këtë pjesë. Është një qëndrim i Shqipërisë dhe gjithë shqiptarëve. Përpjekja për të denigruar luftën çlirimtare në Kosovë është objekti thelbësor i kësaj rezolute. Ky është qëndrimi i duhur që duhet të mbajë sot Shqipëria. Falënderoj deputetët e Kosovës. Dua t'ju them se kanë qenë kontakte disamujore. Falënderoj edhe mediet e Kosovës për një vëmendje për këtë dokument. Ne me deputetët e Kuvendit të Kosovës jemi në kontakt të përditshëm. Kjo legjislaturë do të mbahet mend se bashkëpunimi me deputetët e Kosovës ka arritur nivelin më të mirë të mundshëm në shumë vite. Ne kemi gati një dokument të rëndësishëm të një memorandumit partneriteti. Në nëntor të këtij viti do të kemi një seancë plenare në funksion të dy institucioneve tona. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës është i shkëlqyer. Objektivi ynë i radhës është anëtarësimi i Kosovës në Këshillin

e Evropës. Jemi në fazën e mbërritjes së konsensusit”, ka thënë Balla. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar të martën në Bruksel se Gjykata Speciale në Hagë është krijuar në bazë të një raportit të mbushur plot me gjetura. Ai është shprehur se nga hetimet nuk ka asnjë provë për trafikim të organeve nga udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇL). Me këtë rast, Rama ka thënë se Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) duhet të kërkojë falje për raportin e ish-senatorit Dick Marty. “Është një histori e trafikimit të organeve që u nis nga Rusia dhe jo nga dikush tjetër. Dhe nga zëdhënës rusë, mund të them sërish është se duke parë akuzat, nuk ka asnjë, fakte zero apo qoftë edhe dyshime mbi trafikimin e organeve”, ka thënë Rama në një konferencë të përbashkët me përfaqësuesin e lartë të Bashkimit Evropian (BE) me rastin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Më tutje, Rama ka thënë se Gjykata Speciale është krijuar pikërisht me gjeturat e raportit të Dick Matyt. “Dhe, si e vutë re, kjo

EPOKA E RE Lirim GECI

Tiranë, 20 korrik - Kuvendi i Shqipërisë pritet ta votojë sot (e enjte) projektrezolutën e Partisë Socialiste (PS) të drejtuar nga kryeministri Edi Rama, e cila hedh poshtë pretendimet e raportit të Dick Martyt se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë e përfshirë në trafikim organesh. Kryetari i grupit parlamentar në Partinë Socialiste, Taulant Balla, ka thënë se seanca në të cilën do të votohet kjo projektrezolutë do të jetë një ditë solemne për Kuvendin e Shqipërisë, derisa ka

ftuar dhe opozitën të marrë pjesë dhe të votojë në favor të këtij dokumenti. “Në rend dite do të jetë një rezolutë e rëndësishme që rrallëherë i bie radha të diskutohet, mbi pabazueshmërinë e pretendimeve lidhur me trafikimin e organeve në Shqipëri dhe Kosovë, pretendime të ngritura 11 vjet më parë. Pas më shumë se 11 vjetësh, ne propozuesit iniciojmë këtë rezolutë mbi bazën e proceseve të zhvilluara. Ritheksoj se duhet nënvizuar fakti se kemi të bëjmë me një rast ku janë kryer verifikime. Çdo anëtar (deputet)

Përmbajtja e rezolutës kundër raportit të Dick Martyt:


Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Shqipërisë, në vijim të qëndrimeve tona të kahershme për vlerësimin e legjitimitetit të luftës heroike e çlirimtare të UÇK-së dhe duke rishprehur qëndrimin tonë se nuk mund të vendosen paralele midis masakrave çnjerëzore, spastrimeve etnike, deportimeve, vrasjeve, përdhunimeve, plaçkitjeve dhe krimeve të luftës, nga drejtues dhe anëtarë të makinerisë zyrtare luftarake serbe dhe paramilitarët e saj gjatë luftës në Kosovë, nga njëra anë, dhe integritetit e kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së si reagim në mbrojtje të jetës dhe lirisë të popullit në Kosovë, nga ana tjetër.

Bazuar në parimin se çdo dyshim për krime duhet zbardhur nga organet e drejtësisë sipas parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe se nuk mund të ketë çështje pafundësisht në hetim, por dhe se çdo proces duhet të mbarojë dikur, me qëllim që popujt ta gjejnë forcën të pajtohen e jetojnë së bashku duke shëruar plagët e së shkuarës.

Konstatojmë se pas më shumë se dhjetë vjetësh hetime të thelluara nga Task Forca hetimore speciale e Bashkimit Evropian (BE) dhe pasardhësja e saj, Zyra e

Prokurorit të Specializuar, pretendimet e ngritura në raportin e Dick Martyt (Doc. 12462, datë 7 janar 2011), asokohe anëtar dhe raportues i Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKIE), "për vrasje të personave me qëllim të nxjerrjes dhe shitjes së organeve të tyre dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë", të përfshira në Rezolutën 1782 (2011) të APKIE-së, pika 1 dhe pika 4, mbeten të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte e, për rrjedhojë, duhet të konsiderohen si të tilla nga të gjitha institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë qëllim propozojmë këtë "Rezolutë mbi pabazueshmërinë e pretendimeve për trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri", ku i kërkojmë Asamblësë Parlamentare të Këshillit të Evropës të realizojë një raport vijues (Follow up Report) dhe, si rrjedhojë, edhe një rishikim të rezolutës 1782 (2011), duke rivlerësuar pretendimet për trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë, në dritën e zhvillimeve që

kanë ndodhur gjatë kësaj dekade, fakteve, provave dhe informacioneve të përditësuar, sikurse dhe sa i përket angazhimit, gatishmërisë dhe bashkëpunimit të plotë të Shqipërisë dhe Kosovës në shërbim të së vërtetës dhe vendosjes së drejtësisë. Gjithashtu, i kërkohet qeverisë shqiptare të mbetet plotësisht e përkushtuar për ta ndihmuar drejtësinë dhe identifikuar përgjegjësinë për të gjitha krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe përsërit thirrjen e tij për të gjithë të interesuarit që të bashkëpunojnë me mekanizmin ndërkombëtar për kryerjen e funksioneve të mbetura të gjykatave penale (IRMCT), brenda juridiksionit të saj. Kjo projekt-rezolutë, për të cilën besojmë se do ta kemi mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, rikonfirmon edhe një herë, sikurse në rastet e mëparshme, vullnetin e palëkundur për ta ndihmuar drejtësinë dhe mbështetur çdo përpjekje që synon ta zbulojë të vërtetën. Taulant Balla, Mimi Kodheli, Klotilda Bushka, Etilda Gjonaj, Blendi Klosi, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Hatixhe Konomi, Bardhyl Kollçaku, Ilir Pendavinji dhe Arben Pëllumbi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTREZOLUTË

MBI PABAZUESHMËRINË E PRETENDIMEVE PËR TRAFIKIMIN E PALIGJSHËM TË ORGANEVE NJERËZORE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- Duke iu referuar Rezolutës 1782 (2011) të Asamblësë Parlamentare të Këshillit të Evropës ("APKIE") për "Hetimin e pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë", e cila bazohet në një raport (Doc. 12462, datë 7 janar 2011) të Dick Martyt, ("Raporti"), asokohe anëtar dhe raportues i Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në APKIE;
- Duke rikujtuar se Raporti u hartua në vijim të një mocioni për rezolutë (Dokumenti 11574, datë 15 Prill 2008), me autor ish anëtarin e APKIE, Konstantin Kosachev, Federata Ruse, Grupi European Demokrat, bazuar në kujtimet e zj. Carla Del Ponte, ish Prokurorore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Krime Luftë për ish Jugosllavinë ("ICTY"), e cila në librin e saj "Gjuetia: unë dhe kriminelët e luftës", botuar dy muaj pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe rreth tre muaj pasi kishte dhënë dorëheqjen si prokurorore e ICTY, ngrinte dyshime se pjestarë, drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") kishin kryer trajtime çnjerëzore të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe në Shqipëri, krime këto që nuk mund të hetoheshin nga ICTY për mungesë juridiksioni si dhe për shkak të mandatit të kufizuar në kohë dhe territor të kësaj gjykate; Këto pretendime ishin hetuar dhe më parë nga zyra e ICTY, gjatë mandatit të Del Ponte, por nuk ishin gjetur prova për të bazuar pretendimet për kryerjen e këtyre krimeve;
- Duke nënvizuar se Raporti i Dick Martyt, në vijim të pretendimeve të ish prokurorës Carla Del Ponte dhe mocionit për rezolutë të nisur prej deputetit rus në APKIE, Kosachev, edhe pse nuk është një raport faktmbledhës apo hetim, ngre pretendime për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore që dyshohen të jenë kryer nga pjestarë dhe drejtues të UÇK ndaj shtetasve serbë, kosovarë dhe komunitetit rom apo minoriteteve të tjera të Kosovës në territorin shqiptar, me konkretisht në veri të Shqipërisë: Kukës, Burrel, Rripe, Cahan dhe Fushë Krujë, në

Gjykatë e Hagës është krijuar vetëm në bazë të këtij raporti plot me gjeputura që ka sjellë pikërisht në jetë këtë lloj Gjykate Speciale. Hetime pse hetimesh janë bërë në Kosovë dhe Shqipëri, të pavarura nga çdo lloj ndikimi", është shprehur Rama, duke shtuar se asnjëherë nuk ka pasur trafikim të organeve nga luftëtarët e UÇK-së ashtu siç ka pretenduar Martyt në raport. Rama me tone të ashpra ka thënë se do t'i tregojnë botës se raporti i Dick Matyt ishte një maskaradë. Në këtë kontekst, kryeministri shqiptar ka thënë se

raporti i Martyt është një faqe turpi për Këshillin e Evropës (KE). "Zero për qind të trafikimit të organeve njerëzore. Kërkojmë t'i themi botës që kjo ishte maskaradë. Përmes një sasie balte të hedhur ndaj të gjithë vendit dhe një shteti të pavarur siç është Kosova dhe LANÇ-i. Nuk ka asnjë provë të kushedi sa hetimeve që ka pasur trafik të organeve njerëzore nga udhëheqja e kësaj ushtrie që, në fakt, ka qenë viktimë e një sulmi. Askush nuk duhet të përpiqet ta përshtjellojë në mënyrë tjetër. Kjo

ka të bëjë me një faqe turpi të KE-së. KE-ja duhet ta gjejë kurajën të dalë përballë dhe të thotë na falni", është shprehur Rama. Kryeministri Rama ka thënë se është e pamundur të akuzohet një komb i tërë që është çliruar nga regjimi gjenocidal i Serbisë. "Është e pamundur të akuzosh një komb të tërë që u çlirua nga një përpjekje kaq e madhe e koalicionëve demokratike dhe falë një ushtrie çlirimtare përkundër një makinerie të spastrimit etnik dhe krejt papritur

të hidhen në thellësitë e medieve dhe plehrave gazetareske. Kjo ka të bëjë me raportin e atyre që kanë mbështetur KE-në. Shqipëria është shumë e vogël ta ndryshojë fatin e një vendimmarrje në nivel të lartë", ka thënë Rama. Gjykata Speciale është krijuar mbi bazën e raportit të Dick Martyt, ku nga nëntori i vitit 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Thaçi, Veseli, Selimi dhe

Krasniqi qysh në daljen e parë para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat e prokurorisë. Përpos tyre, në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala. Kujtojmë se në muajin maj Edi Rama e kishte vizituar Hashim Thaçin në Hagë. Rama kishte thënë se e ka vizituar Thaçin pasi e kishte marrë malli për të. Po ashtu, Rama e kishte vizituar edhe familjen e Thaçit në Burojë të Skenderajt.

Abdixhiku e Kamberi bisedojnë për gjendjen e shqiptarëve në Luginë

PRISHTINË, 20 KORRIK (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim Shaip Kamberin dhe Ardita Sinanin, me të cilët ka biseduar për gjendjen e shqiptarëve në Luginë dhe domosdoshmërinë e mbështetjes institucionale ndaj popullatës shqiptare atje. Regjistrimi i ardhshëm i popullsisë, mbështetja financiare për Luginë si dhe siguri i teksteve falas shkollore për 4 000 nxënës shqiptarë në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc janë disa nga temat që do t'i ngrehim së bashku në çdo adresim tonin institucional dhe jo vetëm", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se Kamberi do të vazhdojë guximshëm e bindshëm të ushtrojë - siç dhe ka ushtruar deri më tani zërin e shqiptarëve në çdo mundësi të tij.

dhe domosdoshmërinë e mbështetjes institucionale ndaj popullatës shqiptare atje. Regjistrimi i ardhshëm i popullsisë, mbështetja financiare për Luginë si dhe siguri i teksteve falas shkollore për 4 000 nxënës shqiptarë në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc janë disa nga temat që do t'i ngrehim së bashku në çdo adresim tonin institucional dhe jo vetëm", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se Kamberi do të vazhdojë guximshëm e bindshëm të ushtrojë - siç dhe ka ushtruar deri më tani zërin e shqiptarëve në çdo mundësi të tij.



Propozim-rezoluta e Shqipërisë e lë Specialen të zhveshur



Shkruan: Agron HOTI

Të gjithë e dimë që Serbia edhe gjatë periudhës komuniste akuzonte Shqipërinë për përzjerje në punë të brendshme të asaj që atëherë quhej Jugosllavi. Qëllimi ishte që të hapte front me Shqipërinë për të pasur pretekst për t'i tmerruar dhe terrorizuar më pas shqiptarët nën Jugosllavi. Nuk ishte rastësi që të burgosurit shqiptarë përbënin numrin më të madh të të burgosurve në Jugosllavi dhe ku një pjesë e akuzave serbe ishin se shqiptarët po bashkëpunonin me shtetin e tyre amë, Shqipërinë.

Edhe gjatë luftës në vitin 1999 Serbia vazhdimisht i bombardonte fshatrat shqiptare përreth kufirit me Kosovë duke u përpjekur kështu që t'ia hidhte fajin Shqipërisë për agresion ndaj Serbisë në mënyrë që pastaj ta legjitimonte agresionin, spastrimin etnik dhe pushtimin e Kosovës. Por, për fat të mirë, Serbia si gjatë periudhës komuniste ashtu edhe gjatë luftës në Kosovë nuk ia kishte dalë që fajin për mobilizimin dhe luftën e UÇK-së t'ia hidhte Shqipërisë. Ishte dhe është vetë kufizimi i Shqipërisë me troje shqiptare ajo që siguronte kompaktësi shqiptare andej dhe këndeje kufirit duke penguar kështu depërtimin e çfarëdo plani të errët serb.

Megjithatë, Serbia asnjëherë s'i kishte ndalur përpjekjet për t'i hedhur fajin Shqipërisë se gjoja kishte gisht në mobilizimin e UÇK-së në Kosovë. Ngritja e pretendimeve në Raportin e Dick Martit në vitin 2011 në Këshill të Evropës se në veri të Shqipërisë kishte pasur një shtëpi të verdhë, nga ku ishin trafikuar organe njerëzore gjatë luftës në Kosovë, përbën shembullin më tipik të përpjekjeve serbe për ta përfshirë edhe Shqipërinë në krime të pretenduara luftime, për ta kriminalizuar kështu luftën e UÇK-së si dhe për t'i

kriminalizuar bombardimet e NATO-s kundër Serbisë.

Synimi serb ishte se nëse pretendime të tilla do të vërtetoheshin, atëherë Serbia e Rusia do të mund ta komprometonin tërë çlirimin dhe shtetbërjen e Kosovës e bashkë me të edhe tërë Perëndimin që kishte ofruar mbështetjen. Prandaj, themelimi i Gjykatës Speciale ishte instrumenti politik për ta goditur përfundimisht projektin e Kosovës.

Për ta arritur këtë qëllim Serbia e Rusia po shfrytëzonin rrethanat ndërkombëtare: - ShBA ishte e nxënë me luftën ndaj terrorizmit që nga 2001 dhe me krizën financiare që e kishte goditur në vitin 2008; - lufta e ShBA-së ndaj terrorizmit kishte dëmtuar marrëdhëniet transatlantike; - kriza financiare e vitit 2008 e kishte goditur rëndë edhe ekonominë e BE-së; - Kina, Rusia bashkë me vendet Arabe, Iranin dhe Turqinë po fitonin terren në Evropë si në shkëmbime tregtare ashtu edhe në investime të dyanshme dhe kjo natyrshëm po e rriste varësinë e Evropës karshi vendeve aziatike; - problemet e shtetndërtimit në Ballkan Perëndimor nuk po mund të zgjidheshin nga BE, ngase kjo e fundit as sot nuk ka një strategji të tillë shtetndërtimi; - përçarja në BE veç sa kishte filluar të jepte efektet e veta sidomos me krizën greke; - Rusia duke e rritur eksportin e energjisë në Evropë po i frynte edhe më shumë zjarrit të përçarjes si dhe po rriste kontrollin sidomos ndaj elitës politike të BE-së dhe shteteve anëtare të saj; - brenda në Kosovë kishte një përçarje politike e sociale që rridhte që nga lufta 1998-1999, e cila i jepte bazë Serbisë e Rusisë për ta shfrytëzuar këtë frustrim të brendshëm në favor të themelimit të Gjykatës Speciale; - ndikimi i Rusisë në Këshill të Evropës ishte shumë i madh, kjo edhe për faktin se varësia e shumë shteteve evropiane nga energjia ruse, ndaj kjo po i mundësonte Rusisë të projektonte Gjykatën Speciale në zemër të demokracive evropiane siç ishte Këshilli i Evropës.

Prandaj, pavarësisht rezultatit të Gjykatës Speciale, Shqipëria - në Raportin e

Dick Martyt të miratuar nga Këshilli i Evropës - ngelet vendi, në territorin e së cilës pretendohet të jenë trafikuar organe njerëzore nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Dhe përderisa ende ka një rezolutë të Këshillit të Evropës që e kishte miratuar këtë raport famëkeq, atëherë Shqipëria në një apo mënyrë tjetër ishte dhe ngelet pjesë e lojës. Prandaj, Shqipëria ka ndërmarrë tanimë nismën për të dërguar një rezolutë në Këshillin e Evropës, miratimi i së cilës do ta pastronte para se gjithash Shqipërinë nga pretendimet e Raportit të Dick Martyt.

Nuk është e rastësishme që Shqipëria ndërmerri një hap të tillë pikërisht tani, kur po i hapeshin negociatat për anëtarësim në BE. Kjo sepse pretendimet e Raportit të Dick Martit do të mund ta pengonin hapjen dhe mbylljen e kapitujve të BE-së sidomos të atyre 22, 23 dhe 24 që kanë të bëjnë me drejtësinë, bashkëpunimin rajonal dhe sigurinë. Një rezolutë pro Shqipërisë do të hidhte poshtë pretendimet e Raportit të Dick Martit së paku për pastërtinë e territorit shqiptar. Mbi këtë bazë Shqipëria do të pastrohej nga këto pretendime dhe nuk do të kishte më probleme eventuale në rrugëtimin e saj drejt BE-së.

Fundja, Këshilli Evropian në Përfundimet (Konkluzionet) e datës 10-11 dhjetor të vitit 1999 kishte vendosur që vendet që synonin të anëtarësoheshin në BE do duhej që së pari t'i zgjidhin problemet biletarale qoftë edhe përmes Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND). Ishte pikërisht kjo arsyeja se pse Serbia, para se të aplikonte për anëtarësim në BE, t'i kërkonte GjND-së një Opinion Këshillimor nëse pavarësia e Kosovës kishte qenë në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

Pasi që GjND në korrik 2010 kishte vendosur në favor të Kosovës, atëherë Serbisë i ishte njohur statusi i kandidatit në mars 2012 dhe i ishin hapur negociatat për anëtarësim në janar 2014. Pavarësisht hapjes së negociatave, alarmi i Serbisë dhe Rusisë ishte se Kosova pas GjND-së do të mund të ecte e papenguar drejt BE-së

dhe ndërkombëtarizimit të mëtejshëm përfshirë njohjen pavarësisë së Kosovës nga pesë vendet mos njohëse të BE-së; prandaj ky ritëm ndërkombëtarizimi i Kosovës sipas Serbisë e Rusisë me aleatë të tyre duhej ndalur me çdo kusht.

Dhe kjo në fakt edhe u ndal, sepse në prill 2014 Kuvendi i Kosovës pati miratuar Gjykatën Speciale, ku pastaj në qershor 2014 vendi shkon menjëherë në zgjedhje të parakohshme dhe ku pastaj periudha 2014-2017 shënon periudhën e minimumit të demokracisë në Kosovë, kur problemet e jashtme bëhen agenda ditore të brendshme dhe vendi fillon të vendnumërojë krahas dëmtimit të imazhit nga gazi lotsjellës në Kuvend, diçka që nuk ishte parë më parë në historinë më të re të Evropës. Dhe për fat të keq që nga prilli 2014 e deri më sot, si rezultat i Gjykatës Speciale, Kosova vazhdon të shihet nga BE dhe bota si një vend që ka bërë krime luftime duke u përmendur ky pretendim herë pas here edhe në Këshill të Sigurimit nga Serbia me aleatë të saj, ndaj e tëra kjo po pengonte konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Të kthehemi te Shqipëria. Çfarë arrin Shqipëria nëse rezoluta e saj kalon në Këshill të Evropës?

Së pari, me miratimin e një rezolute të tillë Shqipëria hedh poshtë rezolutën e Dick Martit të vitit 2011 se në territorin e saj ishin trafikuar organe njerëzore nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe kjo i heq çfarëdo pengese në rrugëtimin e saj evropian; - së dyti, një rezolutë e tillë pashmangshëm i jep mundësinë si ShBA-së, NATO-s dhe BE-së që të mbështesin Shqipërinë dhe Kosovën në faktorizimin e tyre; - së treti, një rezolutë e Shqipërisë e lë zhveshur Gjykatën Speciale duke i humbur kuptimin dhe misionin e saj ndaj hetimit të trafikimit të pretenduar të organeve njerëzore, ndaj të cilave nuk është gjetur as edhe një provë e vetme; - së katërti, çlirimtarëve tanë në Hagë iu lehtësohet në masë të madhe barra e madhe që po mbajnë mbi supë dhe çmimi i madh që po paguajnë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; - së pesti, bien poshtë të gjitha

pretendimet se populli shqiptar kishte bërë krime luftime e aq më pak trafikim organesh duke e konfirmuar kështu faktin që jemi padyshim populli më paqësor në Evropë duke mos e pushtuar kurrë askënd deri me sot; - së gjashti, përmes rezolutës shqiptare ekspozohet Serbia e Rusia si sponsorizueset e kësaj Gjykate dhe kjo sigurisht që i dëmton imazhin e Serbisë karshi BE-së kur dihet që edhe Rusia tanimë është përjashtuar nga Këshilli i Evropës dhe s'mund ta përkrahë më; - së shtati, vërtetohet pastërtia e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, arsyeja kjo pse tërë Perëndimi e kishte mbështetur; - së teti, ndryshohet perceptimi në Evropë e botë, kuptohet kjo në të mirë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe tërë popullit shqiptar, kur dihet se Serbia dhe Rusia po përipiqeshin të barazonin viktimat shqiptare me agresionin serb; - së nënti, hiqen hezitimet e shteteve të ndryshme për ta njohur pavarësinë e Kosovës dhe për të investuar në Shqipëri; - së dhjeti, Shqipëria dhe Kosova fitojnë terren ndaj Serbisë në Këshill të Sigurimit, Këshill të Evropës, NATO, institucione të BE-së dhe mekanizma rajonale dhe se Serbia nuk do të mund ta barazojë më viktimën me agresorin; - së njëmbëdhjeti, një rezolutë e Shqipërisë e delegjitimon në masë të madhe rëndësinë e Gjykatës Speciale, aspekt ky i cili do të përshpejtonte përfundimin e hetimeve dhe mbylljen përfundimtare të saj; - së dymbëdhjeti, një rezolutë e tillë do t'i sillte avantazhe Kosovës në bisedimet me Serbi, sepse Serbia nuk do të mund të thoshte më se në luftën e Kosovës të gjithë kishin kryer krime luftime; - së trembëdhjeti, një rezolutë e tillë e Shqipërisë kontribuon edhe një shtensionimin e zhvillimeve në Kosovë, ku jo rrallëherë Raportit të Dick Martit dhe Gjykata Speciale ishin përdorur edhe për agjenda politike të brendshme mes kundërshtarësh politikë, të cilat kishin ndikuar në helmimin e raporteve politike e sociale në tërë Kosovën; së katërmëdhjeti, kjo rezolutë do të kontribuonte dukshëm në rikthimin e lavdisë së UÇK-së dhe Krerëve të saj, të cilët edhe sot po mbahen padrejtësisht në Hagë.

Kurti: Kemi dallime rreth marrëveshjes për të pagjeturit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Prishtina ka dallime konceptuale me Beogradin zyrtar lidhur me marrëveshjen për të pagjeturit. Në një konferencë për medie në Prishtinë, Kurti ka pranuar se Kosova dhe Serbia kanë përafuar qëndrimet sa i përket marrëveshjes për të pagjeturit për të cilën po diskutohet në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Brukseli, por ka thënë se Kosova insiston që të përdoret emërtimi "persona të zhdukur me dhunë gjatë luftës". "Beogradi zyrtar insiston të quhen vetëm persona të pagjetur, ne insistojmë të theksohet se kjo është bërë me forcë, është bërë me dhunë, sepse ata nuk janë persona të pagjetur për shkak të fatkeqësive natyrore, por ne kemi familjarë që e dinë se personi i caktuar i uniformuar ose jo ua mori djalin ose vajzën. Pra, bëhet fjalë për rrëmbime të cilët janë bërë me dhunë. Insistimi ynë është që të theksohet edhe kjo", ka thënë Kurti. Sipas autoriteteve në Kosovë, të pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë vazhdojnë të jenë edhe 1 639 persona, kryesisht shqiptarë.

Kurti foli edhe për mungesën e takimeve në nivel të lartë në kuadër të dialogut. Ai tha se gjatë kësaj jave ishte paraparë të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq por, sipas tij, Serbia ka kërkuar të shtyhet takimi. "Arsyeja pse nuk ka takime nuk do të duhet të kërkohej në Prishtinë, por në Beograd. Besoj se faktori kryesor pse ata po u ikin bisedimeve për raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sepse bisedimet nuk janë për Kosovën, janë për raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është për shkak se po e vonojnë konstituimin e Kuvendit, po e vonojnë formimin e qeverisë sepse nuk duan t'i vënë sanksione Rusisë. Pra, ky është leximi im i situatës aktuale", ka deklaruar Kurti.

Kurti dhe Vuçiqi janë takuar dy herë në kuadër të dialogut dhe dy takimet kanë përfunduar pa marrëveshje konkrete. Takimi i fundit i tyre ka qenë më 19 korrik të vitit 2021.

Kurti u pyet edhe për paralajmërimet nga Serbia se mund të ketë destabilizim në komunat veriore, të banuara me shumicë serbe, më 1 gusht, kur është afati i fundit, sipas një vendimi të qeverisë, që të gjitha targat me akronime të qyteteve të Kosovës që lëshohen nga



Serbia të hiqen nga përdorimi dhe veturat të regjistruhen me targa RKS (Republika e Kosovës). Ai tha se personat që duan destabilizim janë ata që nuk e duan sundimin e ligjit. "Ata të cilët janë në listën e zezë të Thesarit Amerikan, ata të cilët kanë fletarrestime në Kosovë, ata të cilët kanë punuar dhe punojnë për struktura ilegale, natyrisht që kanë interes destabilizimin. Problemi është kur interesi i tyre gjen mbështetje politike në Beograd dhe unë besoj se faktorët ndërkombëtarë

duhet të mbajnë shënim me shkronja të theksuara për këtë mbështetje politike që u vjen këtyre kriminelëve që e duan destabilizimin e Kosovës sepse e luftojnë shtetin e Kosovës", ka thënë Kurti. Kryeministri i Kosovës fajësoi Serbinë për pengesa për zbatimin e udhërrëfyesit të marrëveshjes për energjinë në veri të Kosovës, duke paralajmëruar se qeveria nuk do ta subvencionojë energjinë e shpenzuar në veri të vendit gjatë këtij dimri, nëse nuk zbatohet

udhërrëfyesi.

Që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, më 1999, qytetarët e veriut janë furnizuar rregullisht me energji elektrike, por nuk e kanë paguar atë. Rrjedhimisht, për rrymën e shpenzuar në veri qytetarët e komunave të tjera të Kosovës kanë paguar nga xhepi i tyre nga viti 1999 deri më 2017. Gjatë kësaj periudhe faturat e tyre kanë qenë për 3.5 për qind më shtrenjtë. Nga 2017-ta kjo përgjegjësi e pagesës ka kaluar te Qeveria e Kosovës.

KDI: ShSKUK-ja dëmton buxhetin për rreth 57 000 euro duke blerë oksigjenin më shtrenjtë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 20 korrik - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka analizuar dy kontrata të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) për furnizim me oksigjen. Oksigjeni (në formë të gaztë dhe të lëngshme) ka qenë një nga produktet që është përdorur më së shumti për trajtimin e pacientëve të shtrirë në spitale gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.

Përderisa para pandemisë kërkesa për oksigjen ka qenë më e vogël, gjatë pandemisë kërkesa është rritur për disa herë. "ShSKUK-ja, në fillim të pandemisë, 7 maj 2020, kishte lidhur kontratë kornizë me kompaninë 'Medical Group' për furnizim me oksigjen për inhalim për përdorim të menaxhimit të hipoksisë. Çmimi i kontratës për një kilogram oksigjen ishte 1.68 euro dhe në total parashihej të porositeshin 485 736 kg. Mirëpo vetëm dy muaj më vonë, më 23 korrik 2020, ShSKUK



nënshkruan një kontratë tjetër përmes procedurës së negociuar me kompaninë 'Medica' për furnizim të njëjtë, mirëpo këtë herë me çmim 2.01 euro për kg oksigjen, respektivisht rreth 20% më shtrenjtë për njësi. Sasia që është porositur përmes kësaj kontrate është 44 250 kg në vlerë prej 88 942.50 eurosh. Duke qenë se në kohën e zhvillimit të këtij prokurimi, ShSKUK veçse kishte një kontratë aktive me 'Medical Group', ka mundur që të njëjtën sasi ta porosisë

përmes kësaj kontrate me çmim prej 14 602.50 eurosh më lirë", ka njoftuar KDI.

Ndërkohë, KDI ka analizuar edhe një aktivitet tjetër të prokurimit që ka të bëjë me furnizimin me oksigjenin e lëngshëm. "ShSKUK më 1 prill 2021 publikoi aktivitetin e prokurimit 'Furnizim me oksigjen medicinal për nevojat e ShSKUK-së' për furnizim me 5.2 milionë litra oksigjen në vlerë të parashikuar prej 2.44 milionë eurosh. Vlera e parashikuar për një litër

oksigjen ishte 0.47 euro bazuar në kontratën paraprake me 'Medical Group'. Për këtë tender ShSKUK kishte pranuar tri oferta të përgjegjshme ('Medical Group Sh.PK', me çmim për litër 0.38 e; 'Liri - Med Sh.PK', me çmim për litër 0.46e; dhe 'NPT Medica', me çmim për litër 0.37e), me çmime prej 2% deri në 21% më lirë se kontrata aktuale. Megjithatë, pas rreth 50 ditësh nga dorëzimi i ofertave, ky tender ishte anuluar sipas kërkesës nga Barnatorja Qendrore, me arsyetimin se me uljen e rasteve me Covid-19 është zvogëluar edhe kërkesa për oksigjen medicinal. Anulimi i kësaj procedure do të nënkuptonte që do të vazhdohej të bëheshin porosi me oksigjen me kontratën aktive në atë kohë (kontrata me 'OE Medical Group', me çmim 0.47 euro për litër), por që në muajin qershor 2021 kishte arritur në rreth 84% të sasisë së shpenzuar", thuhet në njoftimin e KDI-së.

KDI-ja ka gjetur se edhe pse është anuluar tenderi, ShSKUK vetëm gjatë muajve maj - gusht

2021, kur është nënshkruar një kontratë e re duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, kishte porositur 428 000 litra oksigjen. Po të llogariten me çmimin e kontratës ekzistuese 428 000 litra oksigjen kanë kushtuar 201 160 euro, ndërsa nëse do të nënshkruhej kontrata me kompaninë 'Medica', kjo sasi do të kushtonte 158 360 euro (428,000*0.37), respektivisht 42 800 euro më lirë. "Më 27 gusht 2021 ShSKUK nënshkroi kontratë të negociuar me kompaninë 'Medical Group' me çmim 0.36 euro për një litër oksigjen. Pra kjo kontratë ka mundur të mos ekzistonte fare sikur të lidhej kontrata në muajin qershor me kompaninë 'Medica' me çmim prej 0.37 eurosh. KDI vlerëson se si pasojë e mospërgatitjes, trajtimit të duhur të nevojave për oksigjen dhe veprimeve të gabuara, në të dy rastet e sipërcekura për furnizim me oksigjen, ShSKUK i ka shkaktuar humbje buxhetit publik rreth 57 000 euro", ka njoftuar KDI.

Kush mund të punësohet me skemën e re?

PRISHTINË, 20 KORRIK - Çdo qytetari të Kosovës, i cili është mbajtës i një familjeje në të cilën nuk punon asnjë anëtar, do t'i ofrohet punësim përmes skemës "Qeveria për familjet". Ministri i Financave në Qeverinë e Kosovës, Hekuran Murati, ka bërë me dije hollësitë për punësim në një konferencë për medie.

Për të përfitur nga kjo skemë mbajtësi i familjes duhet të jetë i moshës së punës, 18-65 vjeç, të mos ketë asnjë anëtar të familjes të punësuar dhe të jetë i regjistruar si i papunë apo punëkërkues në Agjencinë e Punësimit të Kosovës (APK).

Sipas Qeverisë së Kosovës, kjo skemë vjen në kuadër të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike. Kjo pako, me vlerë prej 420 milionë eurosh, është miratuar nga Qeveria e Kosovës vitin e kaluar, për t'i ndihmuar qytetarët dhe bizneset t'i adresojnë humbjet e pësuar nga pandemia e koronavirusit.

Bizneseve që i punësojnë mbajtësit e papunë të familjeve do t'u ofrohen subvencioneve nga qeveria. "Subvencionimi është deri në 300 euro. Paga mund të jetë më e lartë, por qeveria subvencion pagë deri në 300 euro", tha Murati.

Bizneset që duan t'i punësojnë këta qytetarë dhe të përfitojnë nga subvencionet duhet të aplikojnë në Zyrat e Punësimit nëpër komunat e tyre.

Nga kjo kategori ato nuk mund të punësojnë më shumë se 30 për qind të stafit ekzistues. "Nëse një kompani ka dhjetë punëtorë, ajo mund të punësojë tre punëtorë përmes kësaj mase", tha Murati.

Bizneset duhet të jenë të



regjistruara dhe aktive në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa organizatat joqeveritare që, po ashtu, kanë interesim për të punësuar mbajtës familjesh, duhet të jenë të regjistruara dhe aktive në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës.

Punëdhënësit duhet t'i paraqesin te Zyrat e Punësimit pozitat që u nevojiten, e pastaj Agjencia e Punësimit do ta bëjë ndërlidhjen mes tyre dhe punëmarrësve.

Aplikimi i punëmarrësve dhe punëkërkuesve për këtë skemë nis nga 18 korriku.

Paga mesatare bruto në sektorin privat në Kosovë është rreth 380 euro.

Kosova është përballur me rritje çmimesh të produkteve dhe shërbimeve nga fundi i vitit të kaluar, kryesisht për shkak të çrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit. Çmimet janë rritur edhe më, pasi Rusia ka nisur luftën në Ukrainë në fund të shkurtit.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), inflacioni në muajin qershor të këtij viti ka arritur në 14.1 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ministri Murati tha se skema "Qeveria për familjet" do të zgjasë aq sa të jetë e nevojshme.

Shuma se sa do t'i kushtojë

buxhetit të Kosovës zbatimi i kësaj skeme nuk u bë e qartë. Në Kosovë asistencë sociale aktualisht marrin më shumë se 25 mijë familje.

Shuma e rregullt që marrin ato, sillet nga 60 deri në 180 euro në muaj, varësisht nga numri i anëtarëve. Të drejtën për asistencë sociale e ka familja në kushte më të rënda ekonomike, pa asnjë anëtar të punësuar.

Të dhënat e fundit të Bankës Botërore për varfërinë në Kosovë janë të vitit 2017 dhe, sipas tyre, mbi 23 për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë në varfëri.

Në skemën "Qeveria për familjet" mund të paraqiten

edhe familjarë me asistencë sociale por, në momentin e punësimit, ata do të hiqen automatikisht nga asistencë, ashtu siç e parasheh edhe Ligji i Skemave Sociale.

Sipas Agjencisë së Statistikave, papunësia në Kosovë është mbi 25 për qind.

Të dhënat e fundit të ASK-së për tregun e punës tregojnë se nga mbi një milion qytetarë në moshë pune në Kosovë, mbi 350 mijë janë të punësuar, ndërsa mbi 120 mijë janë të papunë. Sipas ASK-së, rreth 750 mijë qytetarë janë ekonomikisht joaktivë, që do të thotë se nuk janë të punësuar, as të regjistruar si të papunë dhe as nuk kërkojnë punë.



Emërohet bordi i kompanisë rajonale të ujësjellësit 'Gjakova'

GJAKOVË, 20 KORRIK (ER) - Qeveria ka emëruar bordin e kompanisë rajonale të ujësjellësit "Gjakova". Në mbledhjen e qeverisë mbajtur të mërkurën, Kurti ka paraqitur emrin e kryesuesit dhe të

anëtarëve të bordit. "Për drejtor të bordit të ndërmarrjes publike KRU Gjakova propozoj të emërohen këta kandidatë: Urim Gashi, kryesues; Arianeta Nura, anëtare; Vildane Maloku, anëtare dhe Jeton

Haxhijaha, anëtar", ka thënë ai.

Kreu i ekzekutivit ka thënë se të emëruarit duhet t'i kryejnë detyrat "në përgjegjësi dhe pajtim me ligjin për ndërmarrjet publike".

Hoti kritikon qeverinë Kurti: Inflacioni nuk mund të luftohet me ligje

PRISHTINË, 20 KORRIK (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kritikuar qeverinë Kurti për propozimin e projektligjit që do ta luftonte inflacionin. Ai ka thënë se nuk ka vend demokratik që e lufton inflacionin me ligje. "Sot, qeveria, në vend se të ndërmarrë veprime konkrete për ta zbutur krizën nga inflacioni, propozon një

projektligj. E para, në asnjë vend demokratik dhe me ekonomi të tregut inflacioni nuk mund të luftohet me ligje, por me politika fiskale dhe monetare. E dyta, edhe pse kjo qasje bie në kundërshtim me parimet e ekonomisë së tregut, procedurat e miratimit të këtij ligji marrin së paku tre muaj kohë. Pra, po flasim për muajin nëntor kur ky ligj, në

rastin më të mirë, mund të hyjë në fuqi. E them me keqardhje se kjo qasje për luftimin e inflacionit është jokushtetuese dhe aspak profesionale, pasojat e së cilës do të vazhdojmë t'i bartim të gjithë. Me masat që kemi propozuar si LDK para tre muajsh, barra do të ishte shumë më e vogël për qytetarët", ka shkruar Hoti në "Facebook".



Kujt nuk duhet t'i besohet aspak, Lajçakut apo Bislimit?



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Vazhdojnë edhe për 24 muaj mashtrimet e Lajçakut: Miroslav Lajçak, bashkë me Borrellin, janë të ngarkuar nga BE-ja për "lehtësimin" e dialogut për normalizim të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Që të dy janë të njohur si kundërshtarë të egër të pavarësisë së Kosovës që e kanë bërë publike çdoherë kur i ka pëlqyer Serbisë e që, pastaj, pas reagimeve të shumta në Kosovë, janë arsyetuar se janë keqkuptuar apo keqçituar, deri në "keqkuptimin apo keqçitimin" e radhës. Për bashkëpunëtorë e kanë pasur një mashtrues të nivelit lokal, Besnik Bislimin, si udhëheqës i Kosovës në këto bisedime e që, në fakt, vetëm ka shërbyer si profaturë e Albin Kurtit. E keni dëgjuar thënien e që, përveçse është edhe shqetësim dhe brengë kryesore e kryeministrit Kurti, unë e them se automatikisht duhet të shndërrohet në brengë dhe shqetësim kombëtar, faktin se Besnik Bislimi, nga brenga e madhe për Kosovën, përkatësisht për marrëveshjen për energjinë, thuaja nuk fle fare apo edhe kur bie në gjumë, bie dhe zgjohet me këtë brengë, si Ali Pashë Tepelena për Vasiliqinë! Mashtruesit ordiner, e që është edhe një gënjeshtar kronik, Miroslav Lajçak, iu vazhdua mandati për të vazhduar me këtë biznes edhe për 24 muaj të ardhshëm dhe, me përgjegjësi të plotë e them, se për këtë meritë të mëdha kanë kryeministri Kurti dhe minihauzeni Besnik Bislimi. Aspak Aleksandër Vuçiqi. Tash Lajçaku po e lavdëron Kurtin pasi ky i fundit i paska zbutur qëndrimet për bisedime, nga një i pakompromis si opozitar dhe në fillim të mandatit, në një të disiplinuar krejtësisht, sipas recetës greke. Takimet e shumta dhe komunikimet e shpeshta me Lajçakun kanë ndikuar që këtij mashtruesi t'i vazhdohet mandati ndonëse nuk mund të krenohet me asnjë të arritur. Marrëveshja e "keqe" për energjinë e nënshkruar nga Isa Mustafa u bë më pak e keqe kur u nënshkrua nga Besnik Muçiverca, ndonëse nuk thuhet se ku ishte dallimi midis këtyre dy marrëveshjeve, asaj të nënshkruar nga Isa Mustafa dhe kësaj të kopjuar nga Besnik Muçiverca?! Po të njëjtin fat do

ta këtë marrëveshje për personat e zhdukur për të cilën mashtruesi Lajçak po thotë se 99.5 për qind është pranuar nga palët dhe mungojnë vetëm dy-tre fjalë për t'u nënshkruar. Besoj se ato fjalë janë: "Mirëdita - Dobar dan...". Jam i sigurt se kjo marrëveshje asgjë nuk do të ndihmojë në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur dhe po keqpërdoret sipas parimit Placebo ku pacientit i jepet një ujë me sheqer në vend të një ilaçi që e shëron. Mashtrim sugjestiv i Placebos, megjithatë, prodhon një efekt për pacientin, ndërsa mashtrimi i Lajçakut dhe shegërtit të tij Bislimit vetëm sa do ta vazhdojë ankthin nga pritjet për familjarët e të pagjeturve. Kështu po luhet loja, nënshkruhen marrëveshjet e arritura më parë në mënyrë ciklike, deri në kohën kur të piqet marrëveshja përfundimtare e që është futur në furrë! Disi si menyja në disa restorante ku ushqimi servohet si pjata hyrëse, antipasta, pjata kryesore për të përfunduar me desert e në rastin konkret për Kosovën do të përfundojë me m**sihane. Edhe pas nënshkrimit të marrëveshjes nuk do të largohen problemet. Për marrëveshjen përfundimtare Serbia nuk është aspak e interesuar të arrihet qoftë edhe me koncesione territoriale në veri për faktin se Serbia ka interes që kjo gjendje të jetë e përhershme dhe nuk po i nënshtruhet presionit ndërkombëtar e që nuk mund të thuhet për Kosovën. Serbia është rreshtuar 100 për qind në anën e Rusisë dhe të Putinit, ndërsa nuk ka ndonjë veprim ndaj saj nga bashkësia ndërkombëtare. Në anën tjetër Albin Kurti, kryeministër dhe Vojsa Osmani, presidente ia kanë bërë Putinit dhe Rusisë vrimën e minit 300 groshë dhe çka fituan?! Të trashët e Sules! Pasi Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë BE-ja e futi në lojë maratone, ka mbetur vetëm Kosova e vetmja vrimë e zezë në Evropë andaj po flitet për domosdoshmërinë e liberalizimit të vizave e cila, sigurisht do të ndodhë por se do ta përcjellë ecurinë e bisedimeve për normalizim. Liberalizimi i vizave do të përdoret si ilaç për qetësim kundër kompromisit të dhimbshëm të cilin na e përkujtojnë të gjithë ata që marrin vendime ndërsa, pjesa dërrmuese e qytetarëve të Kosovës mediokritetin dialogues të Besnik Bislimit do ta pranojnë si zgjidhje e natyrshme dhe më pak e keqe se ajo e Hashim Thaçit dhe Isa Mustafës. Menyja e ofruar për arritjen e një marrëveshjeje me


Serbinë e që po i ofrohet Kosovës është një karotë e lodhët prapa prapanicës së kryenegociatorit dhe shkopit të bejsbollit para syve të atyre që eventualisht nuk do të pajtohen me këtë. Jam i sigurt se ky kryenegociator, ana tjetër e pafytyrës së Miroslav Lajçakut do të pranojë çdo gjë që i vendoset në tavolinë. Ka gjasa që edhe në këtë rast të përsëritet rasti i Rambujesë, Kosova nuk do të përfitojë për shkak të gjenialitetit dhe topave të Besnik Muçivercës, por shkak i kryeneçësisë së Aleksandër Vuçiqit. Si dikur Sllobodan Millosheviqi! Për shkak të gjithëpërfshirjes dhe ndjeshmërisë në baza gjinore e që është standard ndërkombëtar, në mesin e mashtruesve të përmendur më lart duhet t'i sigurojë një vend nderi dhe të merituar, deputetes, Viola von Kramon, Mimoza e Gjermanisë.

Zhvillimi ekonomik prodhon bamirësinë: Kryeministri Albin Kurti në të gjitha takimet në Kosovë, Shipashnicë dhe ato ndërkombëtare po deklaronte se Kosova është tregim i suksesit në zhvillimin ekonomik, me një rritje prej 10-përqindësh sikur që i ka 25 000 punësime të reja apo vende të punës. Inflacioni është i papërfillshëm, as 15 për qind. Rrogat, pensionet, dhe ndihmat sociale nuk ka asnjë arsye të rriten shkak se ka qëndrueshmëri në zhvillim. Po në të njëjtën kohë, kancelari gjerman Sholz, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme për shkak të thellimit të krizës ekonomike. Është pritur një vërsim i gjermanëve drejt Kosovës por, në botën e paradokseve po ndodhë diçka e

panatyrshme, qytetarët e Kosovës me tërë këtë zhvillim ekonomik dhe mirëqenie po japin deri në 3 000 euro vetëm për të siguruar një termin për vizë e që eventualisht do të siguronte hyrjen në shtetin gjerman ku është shpallur gjendje e jashtëzakonshme për shkak të krizës ekonomike. Kush është i marrë, në këtë mes? Sipas kryeministrit e fjalës së tij, padiskutueshëm duhet t'i besohet, ne qytetarët jemi të marrë, përjashtuar Besnik Bislimin! Mirëpo, në kohën e krizave më të mëdha dalin në sipërfaqe bamirësit e vërtetë! Unë do t'i veçoja dy raste. I pari ish-deputeti i Kosovës, Sabit Rrahmani, që po hap puse me ujë për banorët e lodhur dhe të varfër në shtetet e Afrikës dhe, i dyti kur LV-ja po hap puse dhe kroje me ujë për deputetët e lodhur dhe të rraskapitur të Kuvendit të Kosovës në këtë vapë të madhe për shkak të punës së madhe që po e bëjnë në Kuvendin e Kosovës! Në këtë rast nuk diskutohet fare humanizmi, por se është vështirë të përcaktohet se kush është më human! Megjithatë, i udhëhequr sipas parimit: "larg syve, larg zemrës...", përparësi do t'i ipja nismës së LV-së për hapje të puseve dhe krojeve në Kuvendin e Kosovës sepse deputetët janë të Kosovës dhe i kemi afër syve si dhe shumë për zemër! ZOT, të lutem bëje mirë! Jep mend aty ku nuk ka. Merrja do mend Besnikut e m'i jap mua sepse shumë kam nevojë për to. Kosovën po e shalojnë kalorësit dhe kalorëset e Apokalipsit që kanë filluar një kryqëzatë kundër të gjithë atyre që i kanë pasur në teftere të tyre partiake. Janë ngushtuar udhët duke u

bërë rrugë qorre kurse po zgjerohen rrugët që çojnë drejt Evropës, Amerikës dhe shteteve tjera. Nuk janë punët aspak mirë, të lihet e tërë kjo mirëqenie e të shkohet drejt një pasigurie ekonomike të shteteve të kapluar me krizë të thellë sikur janë Gjermania, Anglia, ShBA-ja, Franca dhe shtetet skandinave, kjo tregon se jemi afër kiametit. Më herët pata menduar se mburoja kundër kiametit janë budallenjtë, fëmijët dhe kafshët, ashtu shkruan në librat e shenjta. Tash, kur në Kosovë të gjithë janë të mençur, kur nataliteti ka rënë ndjeshëm dhe kur hajvanati është orientuar kryesisht drejt thertoreve dhe tregjeve, përfundimisht i kemi pisk punët! Marshalli Hekuran Murati do të merret me listat e veteranëve të UÇK-së në vend se shkarkohet duke e rrahur me friskë bythëve. Në kohën e operacioneve plastike, nuk ka rëndësi çfarë fytyre keni, e modeloni sipas kërkesave politike dhe partiake. Aktualisht i kemi dy lloj pelegrinazhesh në Kosovë, ata që shkojnë në Mekë për haxh, për të larë mëkate dhe për të fituar sevape dhe këta që shkojnë në Hagë për t'i vizituar pengjet shqiptare. Këta të Hagës atje shkojnë jo për të larë mëkate, por për të bërë mëkate. Sidomos këta të politikës. Sidomos këta të pushtetit që e kanë humbur durimin pse ende nuk janë dënuar me dënime kapitale armiqte e tyre, luftëtarët e UÇK-së, që i kanë çliruar këta politikanë. Realisht, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë dënuar qysh tani duke e marrë dënimin më të madh të mundshëm. Nuk janë vizituar nga Besnik Bislimi!





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Kosova me 13 sportistë në Festivalin Veror Olimpik Evropian për të Rinj

PRISHTINË, 20 KORRIK - Ekipi i Kosovës për të Rinj do të marrë pjesë në Festivalin Veror Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF) Banska Bystrica, i cili nga 24-30 korrik organizohet në qytetin Banska Bystrica të Sllovakisë. Ekipi ynë përbëhet nga 13 sportistë të shtatë sporteve të ndryshme. Atletika prin me tre garues, xhudoja, noti, tenisi dhe badminton kanë nga dy, ndërsa çiklizmi dhe gjimnastika artistike nga një. Në EYOF marrin pjesë sportistë të moshës 15-18 vjeç. Banska Bystrica 2022 është dashur të mbahej në verën e vitit të kaluar, por u shty për një vit shkak i pandemisë Covid-19 dhe shtyrjes së Lojërave Olimpikë "Tokyo 2020". Krahas ekipit, në EYOF Kosovën e përfaqëson edhe tenisista dhe gjyqtarja Blearta Ukëhaxhaj, e cila do të jetë në cilësinë e ambasadores së re olimpikë, e përzgjedhur nga programi për Ambasadorët e Rinj Olimpik të Evropës (EYOA). Për Komitetin Olimpik të Kosovës, EYOF-i i

tanishëm veror është i katërti, pas përfaqësimit në "Tbilisi 2015", "Gyor 2017" dhe "Baku 2019". Deri më tani KOK-u ka vetëm një medalje të fituar në EYOF, me atletin Muhamet Ramadani në "Baku 2019", i cili kishte fituar të artën në hedhjen e gjyles.

Atletikë

Emine Jenuzi
Lorent Mazreku
Vesa Jusufi

Tenis

Altea Hajrizi
Salidin Rama

Çiklizëm

Ömer Azemi

Xhudo

Muhamedin Veseli
Muharrem Hyseni

Badminton

Baton Haxhiu
Fijona Mustafa

Gjimnastikë

Vilëza Zeqiri

Not

Hana Beiqi
Mal Gashi



Të shtunën mbahet turneu për nder të legjendës Fadil Vokrri

PRISHTINË, 20 KORRIK - Nën organizim të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), të shtunën, më 23 korrik, do të mbahet turneu kushtuar legjendës Fadil Vokrri, me rastin e ditëlindjes së tij. Në këtë turne do të marrin pjesë veteranët e Përfaqësueses së Kosovës, veteranët e Kombëtares së Shqipërisë, veteranët e KF Llapit dhe veteranët e FC Prishtina. Në ndeshjen e parë të turneut do të takohen Llap-Prishtina në orën 17:30, ndërsa në orën 19:00 do të zhvillohet ndeshja Kosovë - Shqipëri. Ky turne do të transmetohet drejtpërdrejt në RTK. Të ftuar do të jenë familjarët e legjendës dhe ish-bashkëlojtarët, si Ramadan Cimili, Erdogan Celina, Skënder Shëngyli, Esat



Mehmeti, Rafet Prekazi etj. Po ashtu, të ftuar janë edhe drejtues të institucioneve të nivelit lokal të Podujevës dhe të Prishtinës si dhe atyre të nivelit qendror. FFK, po ashtu, u bënë

ftesë publike të gjithë dashamirëve të futbollit që të jenë të pranishëm në këtë turnir, që në mënyrë sa më madhështore të nderohet vepra dhe karriera e legjendës.

Ekipi spanjoll viziton Qendrën Kombëtare të Xhudos në Pejë

Pejë, 20 korrik - Ekipi spanjoll i xhudos ka vizituar për herë të parë Qendrën Kombëtare të Xhudos në Pejë, ka njoftuar trajneri Driton Kuka, i cila ka thënë se është hera e parë që kemi në kamp stërvitor ekipin e Spanjës.

Vizitë në kamp po bëjnë edhe ekipet e Anglisë, të Kroacisë e të Çekisë. "Tanimë qyteti ynë i bukur është bërë pikë e rëndësishme për vizitë falë sukseseve të sportit të xhudos", ka shkruar Kuka në "Facebook".



Xhaka: Arteta nuk më lejoi të largohem nga Arsenali

Londër, 20 korrik - Granit Xhaka ka pranuar se ishte afër largimit nga Arsenali, pikërisht me destinacion Romën. Mesfushori i Zvicrës, i intervistuar nga "ESPN",

pranoi se roli i Mikel Artetës ishte vendimtar që ai të qëndronte tek Arsenali. "Pa të nuk do të isha më në këtë klub. Ai më ndihmoi shumë kur isha poshtë. Më mori mënjanë dhe

me gjera të vogla, hap pas hapi, ai më ndihmoi edhe me tifozët. Kam pasur shumë fansa, por duhet të them që Arteta është nga më të mirët që kam pasur ndonjëherë. A isha

pranë Romës? Po, kishte diçka. Sa afër? Shumë afër. Asgjë nuk u bë sepse Arteta dhe Edu, drejtori teknik, nuk më lanë të shkoj, donin të qëndroja këtu", ka thënë Xhaka.



Hamiltoni: Podiumet nuk mjaftojnë më, koha për ta shijuar fitoren

LONDËR, 20 KORRIK - Lewis Hamiltoni ka shprehur optimizëm për garën e radhës të Formula 1 që do të zhvillohet këtë fundjavë në Francë. Pas tri podiumeve radhazi, piloti britanik kërkon të bëjë një hap më shumë se një vend i tretë. Ai

kërkon një fitore, që do të ishte e para për të këtë sezon. Shtatë herë kampioni i botës kërkon nga Mercedesi që ta bëjë hapin e madh edhe pse modifikimet kryesore priten pas pushimeve verore. "Jemi gjendur edhe më parë në situata të tilla dhe në

pjesën e dytë të sezonit kemi bërë rikuperime fantastike. Këto dy gara, në Francë e Hungari, janë të mira për të kuptuar ku jemi", ka thënë Hamiltoni. "Kemi sjell gradualisht disa modifikime në makinë, por pas pushimeve do

të shohim se cila do të jetë diferenca reale me Ferrarin e Red Bullin. Në Francë do t'i kuptojmë ato mangësi të vogla që bëjnë dallimin në garë. Shpresoj që pas podiumeve të vijmë edhe fitoret", u shpreh Hamiltoni.



Muriqi te Mallorca, mungon vetëm zyrtarizimi

ROMË, 20 KORRIK - Lazio dhe Mallorca janë afër finalizimit të marrëveshjes për transferimin e Vedat Muriqit në Spanjë. Sulmuesi i Kosovës do të rikthehet aty ku la mbresa të shkëlqyeshme për gjysmë sezon, në Mallorca. 28-vjeçari i kishte realizuar pesë gola dhe i kishte bërë tri asistime në 16 ndeshje me klubin e La Ligas, ku ishte huazuar nga "Biancocelesti". E tash, pasi i dështoi transferimi në Club Brugge, ku nuk i kishte kaluar vizitat mjekësore, nga ky rast përfitoi klubi ishullor spanjoll. Sipas mediumit spanjoll "Marca", Mallorca do t'i paguajë 8 milionë euro për kartonin e futbollistit nga Prizreni. Muriqi do ta nënshkruajë një kontratë



katërvjeçare deri në verën e vitit 2026. Ndërsa sa i përket rrogës, ai do të paguhet përafërsisht sa merrte në Lazio, rroga e tij do të jetë 2,2 milionë euro në vit. Lazio e kishte blerë "Piratin" për afro 20 milionë euro në verën e vitit 2020 nga Fenerbahçe. Por, ai

dëshpëroi me përvojën që e pati në Itali për një vit e gjysmë duke i realizuar vetëm 2 gola dhe duke i bërë vetëm 2 asistime. Interesim për Muriqin kishin shfaqur këtë verë edhe Hull City në Angli, Galatasaray në Turqi dhe Club Brugge në Belgjikë.

Ish-menaxheri i Schumacherit sulmon familjen e legjendës së F1 për 'gënjeshtër' rreth gjendjes së tij

REGENSBURG, 20 KORRIK - Ish-menaxheri i Michael Schumacherit, Willi Weber, ka sulmuar familjen e ish-yllit të Ferrarit për "gënjeshtër" për pasojat e aksidentit të tij fatal në ski në vitin 2013. Legjenda u tërhoq plotësisht nga sytë e publikut pas incidentit, i cili e pa atë vendoset në koma të shkaktuar nga mjekësia për gjashtë muaj. Gjermani u rrëzua dhe goditi kokën në një gur teksa bënte ski me djalin e tij, Mick, në vitin 2013. Pavarësisht se mbante një helm të skijimit, aksidenti shkaktoi një dëmtim të rëndë në tru dhe Schumacher nuk e rifitoi plotësisht vetëdijen deri gjashtë muaj më vonë. Vetëm një vit më parë nga aksidenti, Schumacher përfundoi vitin e tij të fundit në Formula 1 me Mercedesin, por pjesa më e madhe e suksesit të tij sportiv erdhi me Ferrarin dhe Benettonin teksa fitoi shtatë tituj botërorë. Vetëm Lewis Hamiltoni mund ta rivalizojë 53-vjeçarin për sa iu përket vlerësimeve dhe arritjeve, me britanikun që ka



kaluar numrin e fitoreve të tij në Grand Prix sezonin e kaluar. Weber, i cili së pari nënshkroi me Schumacherin në ekipin e tij në Formula 3 në vitet 1980, është në përplasje verbale me familjen e ish-klientit të tij për mungesën e qasjes dhe "gënjeshtër" pas aksidentit të tij në ski. "Ishte një dhimbje e madhe për mua", ka deklaruar Weber për "Gazzetta dello Sport". "Unë u përpoqa qindra herë të kontaktoja (gruan e tij) Corinna dhe ajo nuk u përgjigj. Telefonova Jean Todt për ta pyetur

nëse duhet të shkoja në spital dhe ai më tha të prisja - është shumë herët. Telefonova të nesërmen dhe askush nuk u përgjigj, nuk e prisja një sjellje të tillë dhe jam ende i inatosur për këtë. Më mbajtën jashtë, më thanë që është herët. Mirë. Tani, është vonë. Kanë kaluar nëntë vjet. Ndoshta ata thjesht duhet ta thonë ashtu siç është", ka shtuar ai. "Fillimisht mund ta kuptoja situatën pasi gjithmonë bëja gjithçka që mundesha që Michael të mbronte jetën private. Por, që atëherë kemi dëgjuar vetëm gënjeshtër prej tyre. Vite pas aksidentit, i thashë vetes që të kujdesesha vetëm për familjen, pasi nuk mund t'i ndryshoja gjërat. Ai ishte si një djalë për mua. Edhe sot më dhemb të flas për këtë", ka shtuar më tej ai. Ende nuk dihet se cila është gjendja aktuale e legjendës së Formulës 1, ndërsa gjatë këtij viti priten të publikohet një lloj dokumentari për karrierën e tij, aty edhe ku mund të ndodhë paraqitja e parë publike, pas aksidentit.

SHKURT

Tuchel: Nuk pres që Armando të largohet nga Chelsea

Skuadra Everton dhe West Ham janë të interesuara për Armando Brojën, por trajneri i Chelseat, Tomas Tuchel, ka thënë se nuk pret që shqiptari të largohet nga klubi. "Nuk pres që Armando të largohet. Ne jemi në dijeni për ofertat. Ne do ta marrim vendimin së bashku me pronarët dhe lojtarin. Kur ai ishte këtu, unë e dija se po tentonte të impresiononte për të qenë lojtar i Chelseas", ka thënë Tuchel.

Dybala paraqitet te Roma

Paolo Dybala është bërë edhe zyrtarisht futbollist i Romës. Klubi italian e ka paraqitur futbollistin argjentinas përmes një videoje në rrjetet sociale. Përfaqësuesi argjentinas e mbylli përvojën në Juventus në fund të sezonit që shkoi dhe më pas e kishte statusin e lojtarit të lirë. Edhe pse lojtarin e donin klubet e mëdha evropiane, ai vendosi t'i bashkohet trajnerit Jose Mourinho në Romë. Ish-futbollisti i Palermos ka nënshkruar kontratë trevjeçare, deri në verën e vitit 2025, ndërsa në të është përfshirë edhe klauzola e shkëputjes së kontratës.

Serena Williams zbulon të ardhmen, merr vendimin për US Open

Tenistja amerikane Serena Williams ka konfirmuar pjesëmarrjen në grand slam-in e US Open, që nis më 29 gusht në Nju-Jork. 40-vjeçarja u rikthye në fushë në qershor të këtij viti pas një mungese të gjatë dhe ka vendosur të mos tërhiqet. Ajo ka triumfuar gjashtë herë në karrierën e saj në US Open. Më herët, motra e vogël Williams do të luajë edhe në turneun e Master të Montrealit, që nis pas dy javësh në Kanada. "Nuk do të tërhiqem, thjesht kisha nevojë për t'u relaksuar e rikuperuar si nga ana fizike, po ashtu edhe nga ajo psikologjike", ka thënë Serena Williams. "US Open është turneu i shtëpisë dhe dua të paraqitem mirë. Jam shumë e motivuar për të arritur një rezultat të mirë. Këtu kam fituar trofeun e parë në një grand slam (1999) dhe do të ishte e jashtëzakonshme të fitoja një tjetër në këtë moshë", ka shtuar tenistja amerikane.

Nagelsmanni: Barça nuk ka para, por blen çdo lojtar që dëshiron

Tekniku i Bayern Munchenit, Jrgen Nagelsmann, ka lëshuar disa deklaratatë të forta ndaj Barcelonës pas shitjes së Robert Lewandowsit te spanjollët. Në një konferencë për shtyp, Nagelsmann foli i nervozuar: "Barcelona është i vetmi klub që nuk ka para, por në fund blen çdo lojtar që dëshiron. Nuk e di se si e bëjnë këtë gjë. Është pak e çuditshme, pak e çmendur". Këto deklaratatë janë bërë pak minuta pas zyrtarizimit të sulmuesit polak me Barcelonën dhe Nagelsmannit nuk i del inati që ata i morën sulmuesin e tyre më të mirë dhe jo vetëm.

Guardiola: Neymari është lojtar i jashtëzakonshëm, por City nuk e dëshiron

Kampionët e Francës janë të hapur për ta shitur Neymarin nëse marrin një ofertë të përshtatshme dhe "Etihad Stadium" është shpallur si destinacioni i tij më i

mundshëm i radhës. Sidoqoftë, Pep Guardiola këmbëngul se ai nuk është në radarin e klubit që drejton. Gazeta franceze "Le Parisien" raportoi se Neymari i është

ofruar drejtpërdrejt Manchester Cityt, por trajneri katalanas e ka konsideruar këtë pretendim si të rremë: "Më vjen shumë keq për 'Le Parisien', por nuk është e

vërtetë. Më vjen keq për ta, sepse informacionet që kanë marrë janë të rreme. Neymar është një lojtar i jashtëzakonshëm dhe nga informacionet e mia, ai është

një djalë i mirë. Lëreni të shprehet në Paris. Manchester City blen 150 lojtarë çdo verë, sipas medieve, por kjo nuk është e vërtetë. Më vjen keq për Neymarin, sigurisht!"



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Marigona Veseli nga Prishtina shpall të humbur dëftesën e shkollës Fillore "Anton Zako Çajupi" Bardhosh Prishtinë..
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

